



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ
Nr. _____/2023

PËR
DISA SHTESA DHE NDYSHIME NË LIGJIN NR.113/2020, “PËR SHTETËSINË”

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “b”, e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr.113/2020, “Për shtetësinë”, bëhet ndryshimi dhe shtesa:

Neni 1

Pas pikës 2 të nenit 7 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Një fëmijë i lindur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga prindër me shtetësi tjetër, të cilët janë rezident të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të marrë shtetësi shqiptare me pëlqimin e të dy prindërve”.

Neni 2

Në pikën 4 të nenit 8 “... pas fjalëve në shkronjën “c”...” shtohen fjalët “dhe “e”...”

Neni 3

Në pikën 1 të nenit 9 fjalët “...që ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç...” hiqen.

Neni 4

Pas pikës 1 të nenit 9 shtohet pika 1/1 me përmbajtjen si vijon:

“1/1. Për shtetasin e huaj që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç, shtetësia shqiptare sipas pikës 1 të këtij neni, mund të fitohet vetëm me pëlqimin e të dy prindërve, ose kujdestarit ligjor”.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYETARI

LINDITA NIKOLLA